



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 14 dhe 16 të statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18 si dhe Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019, në pajtim me Shkresën nr.prot.02-129/2 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Nënkyetari i Komunës, merr;

VENDIM

Neni 1

Ngritët grupi punues për hartimin e Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019, në këtë përbërje;

- 1- **Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, kryesues
- 2- **Gëzim Namani**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, anëtar
- 3- **Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtar

Neni 2

Plani i veprimit hartohet në përputhje me Rregullativën dhe brenda afatit të përcaktuar ligjor, në koordinim me njësitë organizative përkatëse të Komunës.

Neni 3


Për punën e kryer Grupi punues e njofton në formë të shkruar Zyrën e Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot.02-020/04-0032882/20
Podujevë,
02 korrik 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 16 të Statutit të Komunës nr.. 01-020/01-50862/18,
në pajtim me Shkresën nr.prot.02-129/2 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Nënkyetari i Komunës, merr;

V E N D I M

I. Aprovohet "Libri i Proceseve për Menaxhimin e Financave Publike të Komunës" i cili përmban komponentët: Procesi i buxhetimit të Komunës, menaxhimi i pagave, marrëveshje për shërbime të veçanta, shpenzime për mallra dhe shërbime, shpenzime për avance dhe para e imët, shpenzime për udhëtime zyrtare, shpenzime të komunalisë, shpenzime për subvencione dhe transfere, shpenzime për investime kapitale, procesi i integruar i investimeve kapitale, menaxhimi i projekteve, procedurat e prokurimit, menaxhimit të kontratave.

II. Libri i Proceseve për Menaxhimin e Financave Publike të Komunës në formë të detajuar është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III. Zyrtarët publik kompetent të Komunës janë bartës të zbatimit të këtij dokumenti.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Drejtorëve të Drejtorive
Zyrtarëve tjerë kompetent
Arkivit

Nr.prot.02-020/05-0032889/20
Podujevë,
02 korrik 2020

Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 14 dhe 16 të statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, Vendimit nr.01-020/04-0032340/20 të Kuvendit të Komunës së Podujevës, për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike të datës 30 qershor 2020, si dhe në implementim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për bashkëfinancimin e ndërtimit të shtëpive për familjet në nevojë e lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” nr.prot.02-550/01-0031503/20 të datës 27 qershor 2020,

në pajtim me Shkresën nr.prot.02-129/2 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Nënkyetari i Komunës, merr;

VENDIM

Neni 1

Formohet komisioni për verifikimin dhe vlerësimin e aplikacioneve/kërkesave dhe përzgjedhjen e 26 familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit, përfituese për ndërtimin e shtëpive të banimit të cilat do të ndërtohen në bashkëfinancim mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”, në këtë përbërje;

- **Arbresha Bashota**, kryesuese, *Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale*
- **Bled Latifi**, anëtar, *përfaqësues i Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”*
- **Jeton Jashari**, anëtar, *përfaqësues i Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”*
- **Ardian Emimi**, anëtar, *Drejtorja e Arsimit*

Neni 2

Detyrat e komisionit janë, verifikimi i aplikacioneve/kërkesave të paraqitura për ndërtimin e shtëpive të banimit, vlerësimi i tyre si dhe përzgjedhja e 26 familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit, përfituese për ndërtimin e shtëpive të banimit.

Neni 3

Për punën e kryer komisioni përgatit raport në formë të shkruar të cilin e dorëzon në Zyrën e Kryetarit të Komunës dhe një kopje Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot.02-500/01-0034116/20
Podujevë,
07 korrik 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE

Neni 1

Tridhjetë e pesë (35) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 3,700 €.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve n'kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Nr.02-400/04-0037216/20
Podujevë, 20 korrik 2020

Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2022 nr.01-400/03-0075925/19, dt. 23.09.2019, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr. 12-320/01-0024552/20, dt. 01.06.2020, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE TË FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Mbështeten 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fermerë përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin “Programi për ushqim të pemëve frutore në formë të lëngët dhe pluhurit”, projekt në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 2

Mbështetja e fermerëve bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/04-0040785/20
Podujevë, 30. 07.2020

